

**Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara
për këshillimin publik të dokumentit:
“Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të
internetit të hapur”¹**

(Pjesë e dokumentacionit të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.16, datë 8.06.2026, për miratimin e “Udhëzimit për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”)

¹ Dokumenti “Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”u publikua për këshillim publik në faqen e internetit të AKEP dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 5.03.2026.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 02.02.2026, ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik të dokumentit “Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”. Dokumenti u publikua për konsultim publik në faqen zyrtare të AKEP gjatë periudhës 03.02.2026 - 05.03.2026.

Në përfundim të procesit të këshillimit publik, në AKEP depozituan komente me shkrim në rrugë zyrtare palët e interesuara si më poshtë:

- One Albania sh.a., me shkresën nr. 425 prot, datë 05.03.2026 (administruar nga AKEP me nr. prot., 352 datë. 06.03.2026)
- Vodafone Albania sh.a. me shkresën nr. LEA/020/LR/EM (administruar nga AKEP me nr. prot., 352/1 datë, 06.03.2026);
- Albanian Fiber Telecommunications sh.p.k (MADCOM) me shkresën nr.064 prot., datë 5.03.2026 (administruar nga AKEP në rrugë elektronike me email)

AKEP, falenderon palët e interesuara për komentet dhe sugjerimet e dhëna të cilat janë të bashkuara sipas çështjeve dhe pyetjeve të këshillimit publik së bashku me qëndrimin e AKEP për komentet e dhëna.

Projekt-Udhëzimi i AKEP dhe Udhëzimet e BEREC (Pyetjet 1-3)

1. Cili është opinionimi juaj në lidhje me përafrimin e plotë të Projekt-Udhëzimit të AKEP me Udhëzimin më të fundit të BEREC BoR (22) 81?
2. A është bërë përshtatja e duhur e referencave të Neneve 177-179 të Ligjit 54/2024 dhe Nenet 3-5 të Rregullores BE 2015/2120?
3. A do jetë e nevojshme përshtatja e mëvonshme e Projekt-Udhëzimit të AKEP me përditësime të ardhme të Udhëzimeve të BEREC?

Komentet e Vodafone Albania

(1) Vodafone vlerëson pozitivisht përafrimin e Projekt-Udhëzimit me BEREC BoR (22) 81, por kërkon fleksibilitet më të madh në interpretim. Ai thekson se interpretimi shumë strikt i disa koncepteve si mos-përputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur, mekanizmi i matjes së cilësisë së internetit dhe përcaktimi i shpejtësive minimale në rrjetet fikse mund të çojë në zbatim më kufizues sesa fryma e udhëzimeve të BEREC. Vodafone sugjeron që përafrimi të mos jetë një transpozim mekanik, por një adaptim proporcional me realitetin teknik dhe tregun shqiptar.

(2) Vodafone vlerëson se përcaktimet e neneve 177-179 të ligjit nr. 54/2024 janë në përputhje me nenet 3-5 të Rregullores BE 2015/2120 dhe nuk ka komente shtesë për këtë aspekt.

(3) Vodafone vlerëson se përditësimet e ardhshme të udhëzimeve të BEREC duhet të reflektohen në mënyrë të vazhdueshme në dokumentet rregullatore të AKEP për të garantuar harmonizimin me acquis të BE dhe zhvillimet teknologjike.

Komentet e One Albania

Ne mendojmë se projekt-udhëzimi është përfruar plotësisht me udhëzimin më të fundit të BEREC BoR (22) 81, dhe ka një përshtatje korrekte të referencave të neneve 177-179 të Ligjit 54/2024 me Nenet 3-5 të Rregullores së BE 2015/2120.

Duke qenë se në kuadrin aktual rregullator përfshirë këtë projekt-udhëzim AKEP ka ndërmarrë përafrimin e plotë sipas Udhëzimit më të fundit dhe Rregullores së BE-së, dhe duke njohur qëllimin e AKEP për harmonizim me praktikën e Bashkimit Evropian dhe për mbështetjen e objektivave të integritetit evropian të Shqipërisë, mendojmë se do të duhet të ndiqen nga afër edhe përditësimet e ardhshme të udhëzimeve të BEREC.

Kjo, jo thjesht për të bërë përfrimin apriori të tyre, por që AKEP të bëjë realisht një vlerësim të vetin mbi rrethanat e tregut tonë lokal me të drejtën për të përshtatur aspekte të caktuara për shkak të specifikave të tregut shqiptar, dhe kjo në vijimësi, jo vetëm në vitin e parë të zbatimit.

Komentet e Albanian Fiber telecommuniations

(1) Subjekti yne, në cilësinë e Ofruesit të Shërbimit të Internet (ISP), vlerëson përpjekjen e AKEP për harmonizimin e kuadrit rregullator me Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe Udhëzimet e BEREC. Megjithatë, duke marrë në konsideratë realitetin e tregut shqiptar (strukturë tregu me marzhe të ulëta, investime të konsiderueshme në fibra optike dhe rrjete mobile, varësi nga kapacitetet ndërkombëtare), propozojmë që disa dispozita të sqarohen ose të riformulohen me qëllim:

- garantimin e plotësisht të kërkesave rregullatore proporcionalisht me impaktin e operatorit në treg;

- aplikimin e masave rregullatore duke bere kujdes qe te mos mbrrijme ne limitet e mbirregullimit (over-regulation), duke konsideruar konkurrencen si rregullator kryesor e paresor te tregut;
- sigurimin e ruajtjen e fleksibilitetit te zgjidhjeve teknike per menaxhimin efikas te rrjetit dhe sherbimeve;
- mbrojtjen e investimeve ne infrastrukture dhe simulimin e teknologjive te reja.

Ne mbështesim plotësisht parimin e aksesit të hapur dhe trajtimin jo-diskriminues të trafikut. Megjithatë, **propozojmë** që në interpretimin praktik të së drejtës për akses “në pothuajse të gjitha pikat fundore” të theksohet qartë se:

- ISP-të nuk mbajnë përgjegjësi për kufizime që burojnë nga palë të treta (p.sh. politika interkoneksioni të operatorëve ndërkombëtarë, kufizime gjeografike të përmbajtjes, sanksione ndërkombëtare, vendime gjyqësore etj).
- Mosarritja e përkohshme e disa pikave fundore për arsye jashtë kontrollit të ISP-së nuk përbën automatikisht shkelje.
- Interneti i hapur favorizon startup-et dhe shërbimet e reja, pasi nuk diskriminohen nga ISP-të.
- Konsumatorët kanë akses të barabartë në internet, pa diskriminim të përmbajtjes. Rrit besimin dhe transparencën.

Propozojmë shtimin e percaktimeve te vecanta per nivelin e përgjegjësisë teknike të ISP-ve.

(2) Garantimi i aksesit të hapur në internet per perdoruesit fundore

Duke qene qe ne kete dokument, referuar ligjit 54/2024 dhe Udhëzimeve të BEREC, behet nje dallim midis ofrueseve te sherbimeve ISP -Internet Service Providers dhe IASP – Internet Acces Service Provider, ku ISP ofrojne qasje ne Internet (Acces Service) dhe njeherazi jane Ofrues te Sherbimeve te Specializuara, nje gje e tille duhet te reflektohet edhe ne percaktimet e Autorizimit te Pergjithshem. Eshte e kuptueshme qe sherbimi i ofruar nga nje IASP (qasje ne internet) eshte i ndryshem dhe teknikisht i thjeshtuar krahasuar me sherbimet e nje ISP e cila ofron qasje ne Internet dhe Sherbime te Specializuara. Per rrjedhoje edhe kushtet ne AP- Autorizm i Pergjithshem, duhet te jene te ndryshme.

Vleresojme qe nje ndarje e tille zgjidh edhe diskutimet mbi diferencat ne ushtrimin e veprimtarise midis nje ISP te strukturuar e cila ploteson te gjithe detyrimet per ofrimin e sherbimit (Acces ne Internet dhe Sherbime te Specializuara), dhe detyrimet per nje IASP e cila ofron vetem lidhjen ne Internet.

Gjithashtu ky klasifikim zgjidh edhe diskutimin lidhur me numrin e madh actual te ISP ne vend, ku realisht shumica e tyre jane thjesht IASP.

Eshte e kuptueshme qe ndersa detyrimet per nje ISP dhe nje IASP jane te ndryshme (Siguria ne rrjet, Parametra te larte te QoS, Suport i mireorganizuar, Ofrimi i Sherbimeve te Specializuara etj), do te jete rrjedhoje qe edhe te drejtat dhe perfitimet, prej sherbimeve qe ofrojne, te jene te ndryshme (Kriteret per pjesmarrje ne tendera, Ofrimi i sherbimit Universal, Zonat e mbulimit, etj)

Qëndrimi i AKEP për komentet për Pyetjet 1-3

AKEP vlerëson komentet e tre operatorëve dhe konfirmon se edhe versioni final i Udhëzimit nuk ka ndryshime materiale nga Projekt-Udhëzimi i nxjerrë në këshillim publik, pra është hartuar në përputhje të plotë me udhëzimet e BEREC. Qëllimi i dokumentit është harmonizimi me kuadrin evropian duke marrë në konsideratë edhe specifikat e tregut shqiptar.

AKEP merr në konsideratë vlerësimin pozitiv të tre operatorëve për reflektimin në mënyrë të saktë Projekt-Udhëzim të referencave dhe përafrimit ndërmjet ligjit shqiptar dhe Rregullores së BE

Në lidhje me komentet e Vodafone dhe Madcom për nevojën për fleksibilitet dhe adaptim të udhëzimeve të BEREC me realitetin teknik dhe tregun shqiptar, AKEP në Shtojcën 1 të dokumentit të nxjerrë në këshillim publik, ka përfshirë dhe përvojën e zbatimit të rregullave të internetit të hapur në vendet e BE, si dhe propozimin e AKEP për një qasje të kujdesshme dhe proporcionale me kushtet e tregut shqiptar, duke propozuar dhe një periudhë kohore tranzitore me zbatim fleksibël të rregullave në lidhje me shpjëtesitë e internetit në rrjet fiks.

Në Shtojcën 1 të dokumentit final të udhëzimeve AKEP ka dhënë sqarime shtesë për qasjen dhe planin e AKEP për zbatimin e rregullave të internetit të hapur duke marrë në konsideratë kushtet e tregut në Shqipëri.

AKEP është dakord që kuadri rregullator duhet të mbetet i përditësuar me praktikën evropiane. Çdo përditësim i ardhshëm i udhëzimeve të BEREC do të analizohet dhe nëse është e nevojshme, do të reflektohet në përditësime të mëtejshme të udhëzimit të AKEP.

Në lidhje me propozimet e Albanian Fiber Telecommunications (Madcom), AKEP sqaron se:

- Sqarimet e dhëna në Udhëzimin e AKEP konsiderohen të mjaftueshme dhe shteruese dhe nuk ka nevojë për riformulime/sqarime shtesë për të shmangur mbirregullimin, apo për interpretim më të zgjeruar në lidhje me shprehjen *akses “në pothuajse të gjitha pikat fundore”*;
- Termi (Ofrues i Shërbimit të Internetit) dhe shkurtimi ISP (si edhe termat dhe shkurtimet e tjera) i dhënë në paragrafin 2 të Udhëzimeve të AKEP është plotësisht në përputhje me udhëzimet e BEREC BoR (22) 81.
- Dallimi i propozuar midis ISP- Internet Service Provider (si ofrues/sipërmarrës që ofron njëkohësisht shërbim të aksesit në internet dhe shërbime të specializuara) dhe IASP - Internet Access Service Provider (si ofrues/sipërmarrës që ofron vetëm shërbimin e aksesit në internet) nuk është i nevojshëm dhe nuk mbështetet në kuadrin aktual ligjor dhe rregullator të:
 - o Ligjit 54/2024 dhe Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm, miratuar me VKD nr.10, datë 31.03.2026;
 - o Rregullores (BE) 2015/2120 apo EECC;
 - o Udhëzimeve të BEREC BoR (22) 81.

Gjithashtu, AKEP sqaron se “shërbimet e specializuara” nuk përbëjnë kategori të veçantë autorizimi dhe fakti që një sipërmarrës ofron edhe shërbime të specializuara, krahas IAS, nuk krijon automatikisht një kategori të ndryshme operatori në kuptim të Autorizimit të Përgjithshëm.

Pra, ofrimi i shërbimeve të specializuara nuk përbën kriter të përshtatshëm për klasifikimin bazë të sipërmarrësve në kuadër të regjimit të autorizimit të përgjithshëm, dhe se përdorimi i terminologjisë së re “IASP” mund të krijojë paqartësi dhe mospërputhje me terminologjinë e përdorur në kuadrin rregullator të BE-së dhe në dokumentet e BEREC.

Specifikime shtesë për shpejtësitë minimale dhe Normalisht të disponueshme (NAS) në rrjetet fikse

4. A janë të përshtatshme dy alternativat e propozuara nga AKEP për specifikimet e shpejtësive (minimale, NAS) të internetit në rrjetet fikse në Shqipëri (seksioni 4.1 i kësaj Shtojce)?
5. Cila prej dy alternativave është më e përshtatshme: Alternativa 1 apo Alternativa 2?
6. A duhet të japë AKEP më shumë specifikime për alternativën e përzgjedhur në përfundim të kështillimit publik? Nëse po, çfare specifikimesh?

Rrjetet celulare

7. A jeni dakord me propozimin e AKEP për të mos kërkesa shtesë, përveç përcaktimeve në Nenet 177-179 të Ligjit 54/2024 dhe në Projekt-Udhëzim, për shpejtësitë e internetit në rrjetet celulare?

Komentet e Vodafone Albania

(4) Vodafone vlerëson se dy alternativat e propozuara nga AKEP për përcaktimin e shpejtësive minimale dhe NAS janë në parim të përshtatshme. Megjithatë, sipas Vodafone, Alternativa 1 kufizon fleksibilitetin e operatorëve dhe mund të mos përshtatet me diferencat infrastrukturore në zona të ndryshme.

(5) Vodafone preferon Alternativën 2 (qasje vetërregulluese), ku operatorët përcaktojnë vetë shpejtësitë minimale dhe NAS sipas topologjisë së rrjetit dhe kushteve teknike.

(6) Vodafone sugjeron që AKEP të japë specifikime shtesë për alternativën që do të përzgjidhet, duke përfshirë metodologjinë e matjes, tolerancat peak/off-peak dhe sqarimin e trajtimit të shërbimit FËA.

(7) Vodafone është dakord me propozimin e AKEP për të mos vendosur kërkesa shtesë për shpejtësitë e internetit në rrjetet celulare, por kërkon sqarime për detyrimet e transparencës dhe publikimin e shpejtësive sipas zonave.

Komentet e One Albania

(4) Duke ju referuar dhe praktikës së implementuar në vendet e EU-së, shoqëria ONE Albania shpreh mbështetjen e saj ndaj **Alternativës 2** të propozuar nga AKEP.

Komentet tona mbi përshtatshmërinë më të mirë dhe arsyet e zgjedhjes nga shoqëria ONE Albania të Alternativës 2 kundrejt Alternativës 1 janë dhënë në përgjigje të pyetjes 5 më poshtë.

(5) Ne mendojmë se duke qenë hera e parë për implementimin e këtyre kërkesave rregullatore, për të gjithë ISP-të do të ishte më e përshtatshme një qasje vetërregulluese sipas Alternativës 2 "Qasje vetërregulluese ku cdo ISP përcakton vet shpejtësitë minimale dhe normalisht të disponueshme". Kjo qasje përveçse krijon fleksibilitet për ISP-të në specifikimin e shpejtësisë minimale, normalisht të disponueshme dhe maksimale, njëkohësisht i përgatit operatorët për të konsoliduar praktikën rregullatore të monitorimit sipas mekanizmit të certifikimit që do të implementohet nga AKEP.

Por njëkohësisht theksojmë se shoqëria ONE Albania konsideron shumë të ngushtë propozimin e AKEP për afatin kohor tranzitor të aplikimit të Alternativës 2 vetëm për 2026-2027, pasi praktikisht, duke konsideruar kohën se kur mund të fillojë hyrja në fuqi, kjo periudhë nuk është as 1 vit kalendarik. Pra ky afat i ngushtë nuk mundëson as të informohet apo edukohet pajtimtari mbi parashikimet e reja të transparencës në kontratë, dhe as të maturohet praktika e zbatimit të këtyre klauzolave.

Synimi përmes kësaj qasjeje, **Alternativës 2**, është që ISP-të të edukohen dhe të ndërgjegjësohen përmes vetërregullimit mbi këto praktika të reja rregullatore dhe po ashtu konsumatorët të ndërgjegjësohen mbi mjetet juridike në dispozicion lidhur me performancën e shërbimeve të kontraktuara.

Kjo duke patur në konsideratë edhe praktikën e shteteve të EU-së, në të cilat, referuar raportit të BEREC për vitin 2017 (Viti i parë i implementimit të Rregullave të hapura për Internetin), vetëm në 5 nga 29 vende

të EU-së u përcaktuan eksplicitisht në mënyrë detyruese shpejtësia minimale dhe shpejtësia normalisht e disponueshme në % të shpejtësisë maksimale.

Gjithashtu, Alternativa 2, në terma të mirëinformimit dhe ndërgjegjësimit të përdoruesit fundor mbi pritshmëritë reale të shërbimit të kontraktuar, siguron abonentin se cila është shpejtësia minimale, standarte, dhe maksimale në % ndaj shpejtësisë së reklamuar për një ofertë/plan tarifar të publikuar, dhe kohën/periudhën kur këto shpejtësi mund të arrihen. Ky informacion, që do të jetë pjesë e kontratës e pajis abonentin me të gjithë të dhënat për të kontrolluar performancën e shërbimit të kontraktuar dhe për të ndjekur rrugën ligjore në rast të mosarritjes së performancës së përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, kjo alternativë i jep mundësinë ofruesit të Shërbimeve të Internetit të përcaktojë parametra shpejtësie realiste bazuar në aftësitë e rrjetit, duke i dhënë përparësi efikasitetit të rrjetit mbi minimumin e garantuar. Për këtë shpejtësi, abonenti do të jetë i ndërgjegjshëm që në momentin e marrjes së vendimit për të nënshkruar një kontratë shërbimi me një ISP të caktuar.

Vetë ISP-ja, për arsye të konkurrencës kundrejt ISP-ve të tjera në po të njëjtën zonë, do mbetet vecanërisht i interesuar për ofrimin e shërbimit me shpejtësi sa më të lartë të internetit, ndaj dhe do rritë investimet e tij për ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme të rrjetit.

Ndërsa, ndjekja e qasjes së **Alternativës 1**, për më tepër që në krye të herës së zbatimit të Rregullave për Internetin e Hapur në Shqipëri, do ishte e sforcuar, e shpejtë dhe ushtron presion të madh ndaj operatorëve për zbatimin e parametrave të parapërcaktuara për shpejtësitë minimale, maksimale dhe "normalisht të disponueshme".

Për më tepër, përsa i takon Alternativës 1, vlerat e propozuara për teknologjinë e rrjetit të aksesit me FEA për shpejtësinë minimale dhe për shpejtësinë normalisht të disponueshme janë shumë të larta, respektivisht 40% dhe 70% e shpejtësisë maksimale. Ndërkohë, që në raportin e BEREC për vitin 2022 (pra 5 vite pas implementimit të Rregullave për Internetin e hapur), ka shtete si Sllovenia (SI), për teknologjinë FEA, ka përcaktuar shpejtësinë minimale dhe shpejtësinë normalisht të disponueshme respektivisht 25% dhe 50% e shpejtësisë maksimale.

Ndaj, duke theksuar qëndrimin e ONE Albania për mbështetjen e Alternativës 2, në cdo rast të konsiderimit të Alternativës 1, ONE Albania i kërkon Autoritetit rishikimin e vlerave për shpejtësinë minimale dhe normalisht të disponueshme dhe vecanërisht për FEA, në vlerat 25% dhe 50% të shpejtësisë maksimale.

(6) Mendojmë se, në përfundim të këshillimit publik, në udhëzimin e miratuar, lidhur me specifikimet e shpejtësisë së internetit, minimale, normalisht të disponueshme dhe maksimale, për të cilat ne dakortësojmë Alternativën 2 të propozuar nga AKEP, për qasje vetërregulluese të ISP-ve, si dhe përfshirjen në kontratat e pajtimit të pikave nga 1-3 cilësuar në këtë alternativë², sugjerojmë që të ketë përcaktime më të qarta teknike për shpejtësinë minimale dhe metodologjinë e matjes. Shpejtësia në rrjetet fikse varet shumë nga pajisja fundore dhe mënyra e matjes (p.sh. për shpejtësi mbi 1G nevojiten pajisje me karta rrjeti 1G+ dhe matje me kabell, jo EFi. Prandaj, vlerësojmë të nevojshme të cilësohen gjithashtu në udhëzim kriteret apo rregullat e qarta që do të duhet të ndjekë përdoruesi fundor për verifikimin e shpejtësisë së lidhjes së tij kundrejt shpejtësisë minimale, shpejtësisë normalisht të disponueshme apo shpejtësisë maksimale të shënuar në kontratë.

Kështu, për ta bërë sa më të zbatueshëm këtë udhëzim, për të shteruar për sa është e mundur pretendimet e palëve në një proces mosmarrëveshjeje mbi shpejtësinë e matur të internetit nga një përdorues fundor, dhe për të siguruar transparencë në marrëdhënien me pajtimtarët, ONE Albania sugjeron që për verifikimin/testimin e shpejtësisë së garantuar në kontratë, duhet të ndiqen e zbatohen rregullat e mëposhtme:

1. Speed test të jetë me serverin e sipërmarrësit nga i cili merret shërbimi, deri në momentin e vendosjes së një mekanizmi 'tool-si' të certifikuar nga AKEP.
2. Modemi internetit me PC që kryen testet të jenë me lidhje me kabell (pasi performanca e ëireless ndikohet nga faktore rrethanorë).
3. PC që kryen matjet të sigurohet që:

² ISP- të përfshijnë në kontratat e pajtimit:

1. periudhat e ditës kur shpejtësia maksimale është arritshme;
2. periudhat kur pritet të arrihet NAS;
3. periudhat kur shpejtësia mund të ulet pranë minimumit.

- a. nuk është duke kryer doëload-e/upload-e të tjera në background,
- b. Nuk është i infektuar,
- c. Ka parametra te përshtatshëm për këtë lloj matje si dhe prodhim i viteve të fundit, jo më shumë se 3 vite vjetërsi nga data e matjes për shpejtësitë mbi 1 Gbps
4. Të jetë i lidhur vetëm ky PC në modem/CPE dhe të mos ketë asnjë pajisje apo aplikacion tjetër që përdor internetin.
5. Ëireless i modemit rekomandohet të jete i fikur gjatë testeve.

Përbushja e këtyre rregullave nga ana e përdoruesit fundorë duhet të provohet me evidenca në format video për shkak të mundësive të larta për manipulim të evidencave në format jpg, etj.

(7) Duke ju referuar dhe rezultateve të matjeve të kryera nga përdoruesit fundorë në Shqipëri të rrjeteve celulare, në Tetor 2025, të dhënat për të cilat janë pasqyruar në faqen 64 të projekt-udhëzimit, e vlerësojmë të arsyeshëm propozimin e AKEP për të mos vendosur kërkesa shtesë për shpejtësitë e internetit në rrjetet celulare, vec atyre të përcaktuara në nenet 177-179 të Ligjit 54/2024.

Komentet e Albanian Fiber Telecommunications

(4-6) Propozimi për përcaktimin e shpejtësisë minimale dhe NAS (Normally Available Speed) duhet të marrë në konsideratë:

- ndryshimet midis rrjeteve fikse dhe mobile,
- ndikimin e faktorëve jashtë kontrollit të ISP-së (Ëi-Fi i brendshëm, pajisje e përdoruesit, serveri i destinacionit).
- Etj,

Propozojmë që:

- Shpejtësia minimale të përcaktohet në mënyrë realiste dhe teknikisht të arritshme.
- Për rrjetet mobile, të përdoren intervale statistikore dhe jo vlera fikse.
- Të parashikohet tolerancë teknike për devijime rastesore në procesin e vlerësimit e matjes.

(7) Jemi dakord me propozimin e AKEP-it për të mos parashikuar kërkesa shtesë.

Qëndrimi i AKEP për komentete për Pyetjet 4-7:

AKEP vlerëson komentet e paraqitura dhe thekson se qëllimi i përcaktimit të këtyre parametrave është garantimi i transparencës dhe mbrojtja e përdoruesve fundorë.

AKEP duke marrë në konsideratë preferencat dhe argumentat e operatorëve, përfshirë përvojën në vendet e BE-së, sidomos në vitet e para të implementimit të Rregullores së BE 2015/2120, në versionin final të Udhëzimeve, ka përcaktuar aplikimin Alternativës 2. AKEP në Shtojcën nr.1 të Udhëzimit ka dhënë saqime shtesë në lidhje me zbatimin e Alternativës 2.

Interpretimi i termave “mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht”

8. Cili është opinionin juaj për propozimin e AKEP në lidhje me interpretimin e termave “mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht”?

Komentet e Vodafone Albania

Vodafone konsideron se propozimi i AKEP për interpretimin e termave “mos-përputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur” (≤80% për 3 ditë rresht) është shumë i ngurtë dhe mund të rrisë numrin e ankesave, veçanërisht për shkak të faktorëve jashtë kontrollit të operatorit si pajisjet e abonentit ose Eë-Fi.

Komentet e One Albania

Duke ju referuar raporteve të BEREC mbi praktikën e ndjekur nga vendet Europiane në interpretimin e termave “mospërputhje e rëndësishme, vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht”, vërejmë se AKEP i është referuar eksplicitisht rregullit të Qipros. Por po ashtu, në këto raporte vërejmë se vetëm në 13 vende anëtare nga 27 vende të EU-së, interpretimi i termave “**mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht**”, është i vendosur nga Autoritetet Rregullatore. Pra, janë më shumë se gjysma e vendeve të EU-së, Autoritetet Rregullatore të cilave, që nga miratimi i Rregullores së EU-së mbi internetin e hapur në vitin 2015, nuk kanë zgjedhur të imponojnë përkufizimin e interpretimit mbi këtë cilësim, por kanë ndërmarrë qasje të ndryshme, të tilla si interpretim vullnetar, udhëzim jo detyrues, etj.

Prandaj, shoqëria ONE Albania vlerëson se në linjë edhe me qasjen vetrregulluese të propozuar nga AKEP, alternativa më e përshtatshme do të ishte që operatorët të paraqesin propozimin e tyre të interpretimit të këtij përkufizimi gjatë procesit të rishikimit të kushteve dhe termave të shërbimit nga ana e operatorëve të cilët do duhen t'i rishikojnë ato, për të reflektuar ndryshimet që kërkohen nga Udhëzimi i miratuar për zbatimin e rregullave për internetin e hapur.

Në mënyrë alternative, në rast se AKEP nuk pranon sugjerimin e ONE Albania si më sipër, vlerësojmë të nevojshme se përkufizimi i interpretimit të propozuar nga AKEP do duhet gjithsesi të rishikohet dhe përditësohet duke argumentuar si në vijim:

Duke patur parasysh që është viti i parë i implementimit të këtyre rregullave, që në tregun e shërbimeve e rrjeteve fikse janë rreth 200 ISP të cilat do të duhet të zbatojnë dhe të sigurojnë përputhshmërinë me përcaktimet e Udhëzimit, si dhe duke iu referuar praktikave të konsoliduara rregullatore nga Autoritetet Rregullatore të Kroacisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, në sugjerimin tonë paraprak, propozimi i AKEP për interpretimin e termave “**mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht**” duhet të përditësohet dhe të përfshijë elementë të tjerë të cilët vlerësojmë se do të mund ta bënin më të zbatueshëm, do të ndihmonin realisht në zgjidhjen e problemit apo faktimin e mospërputhshmërisë nga ana e përdoruesit fundor, dhe njëkohësisht do t'i jepnin hapësirë ofruesit të shërbimit për të adresuar dhe zgjidhur problematikën dhe për t'i siguruar përdoruesit fundor shërbimin e kontraktuar prej tij.

Kështu, duke patur parasysh se qëllimi i cdo ISP-je që ofron shërbime interneti në thelb është vazhdimësia e shërbimit, do të duhet që interpretimi i AKEP mbi mospërputhjet e rëndësishme, të vazhdueshme ose të përsëritur rregullisht të ketë disa elementë plotësues që sigurojnë eksperiencën e mirë të abonentit në terma të cilësisë së shërbimit dhe njëkohësisht ti garantojnë ISP-ve kohën e nevojshme për marrjen e masave dhe rregullimin e shërbimit në përputhje me nivelet e cilësisë dhe shpejtësinë e internetit të kontraktuar. Prandaj, ashtu sic është e parashikuar në cdo kontratë shërbimi, duhet që abonenti të reklamojë ankesën e tij pranë ofruesit të shërbimit, e cila sipas sugjerimit tonë në interpretimin e përditësuar më poshtë duhet të raportohet të paktën brenda 3 ditëve nga momenti kur abonenti ka kryer matjet e shpejtësisë (sipas dhe rregullave të propozuara nga ONE Albania në përgjigje të pyetjes 6 më lart) dhe më tej Operatori në përputhje me përcaktimet në termat dhe kushtet e kontratës duhet të zgjidhë ankesën brenda 72 orëve nga marrja e saj. Në cdo rast, pavarësisht llojit të ankesës dhe komunikimeve të vazhdueshme për zgjidhjen së problemit, ky afat nuk mund të kalojë 30 ditë nga marrja e ankesës së abonentit, sipas edhe përcaktimeve të Ligjit nr. 54/2024, neni 46, pika 3, sipas të cilit “Pas marrjes së kërkesës, ofruesi i përgjigjet përdoruesit fundor me shkrim, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së kërkesës së përdoruesit fundor.”

Në vijim të argumentimit më sipër si dhe duke u bazuar dhe në interpretimin e Autoritetit Rregullator të Kroacisë^[1], si dhe në kërkesat e Autoritetit Rregullator të UK^[2] për të vërtetuar dështimin e dhënies së shërbimit të kontraktuar përdoruesit fundor, ONE Albania sugjeron paraprakisht përditësimin e përkufizimit të propozuar nga AKEP si më poshtë:

[1] BEREC Report on the implementation of Regulation (EU) 2015/2120 and BEREC Net Neutrality Guidelines, fq.26

[2] Cullen Report, CTTEE20260003 “Transparency requirements for broadband contractual speeds”- 30 Jan. 2026 - Alessandro Mauro, fq 13

Propozimi i AKEP:

~~“Mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht”: rezultatet e matjeve gjatë tre ditëve të njëpasnjëshme tregojnë se shpejtësia e marrë nga përdoruesi fundor është më e vogël ose e barabartë me 80% të shpejtësisë minimale ose normalisht të disponueshme (NAS) të specifikuar në kontratën e pajtimit nga ofruesi i shërbimit të internetit në rrjet fiks.~~

Propozimi i ONE Albania:

“Mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht”: kur të paktën 3 rezultate të matjeve gjatë pesë ditëve të njëpasnjëshme tregojnë se shpejtësia e marrë nga përdoruesi fundor është më e vogël ose e barabartë me 70% të shpejtësisë minimale ose normalisht të disponueshme (NAS) të specifikuar në kontratën e pajtimit nga ofruesi i shërbimit të internetit në rrjet fiks, dhe problematika e raportuar nga pajtimtari brenda 3 ditëve nga matja e fundit nuk është zgjidhur përfundimisht brenda 30 ditëve kalendarike nga ana e operatorit.”

Pavarsisht sa më lart, ONE Albania ruan të drejtën të paraqesë edhe versione të tjera të rishikuara apo të ruajë të njëjtin propozim, gjatë procesit të rishikimit të kushteve dhe termave të shërbimeve për pajtimtarët.

Qëndrimi i AKEP për komentete për Pyetjen 8:

AKEP vlerëson shqetësimet e operatorëve dhe në versionin final të Udhëzimeve (Shtojca 1: Seksioni 2.2) ka bërë disa saktësime/sqarime shtesë, duke marrë në konsideratë sugjerimet e operatorëve.

Mekanizmi i certifikuar i monitorimit cilësisë së Internetit

9. A jeni dakord me planin/afatin propozuar për periudhën 2026–2027 për krijimin e mekanizmit të certifikuar nga AKEP?
10. Cilat funksione duhet të ketë mjeti? (Për funksionet, ju lutem referojuni dhe mekanizmave të vendeve/NRA-ve sipas Tabelës 4 në seksionin 4.3 të kësaj Shtojce)

Komentet e Vodafone Albania

(9) Vodafone e konsideron realist afatin 2026-2027 për krijimin e mekanizmit të certifikuar të matjes së cilësisë së internetit.

(10) Vodafone propozon që mjeti i matjes të përdorë standarde të unifikuara serverash (p.sh. Ookla), të privilegjojë matjet me Ethernet dhe të marrë në konsideratë faktorët teknikë si pajisjet CPE dhe ndërprerjet e rrjetit.

Komentet e One Albania

(9) Ligji nr. 54/2024, në nenin 178, pika 3 përcakton qartë se e vetmja mënyrë për të përdorur mjetet juridike të parashikuara nga ky nen është që faktet përkatëse do duhen të jenë të vërtetuara nga një mekanizëm monitorues, i certifikuar nga AKEP.

Gjithashtu, në këtë nen referohet se ky paragraf zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ose të rinovuara 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pra ligjvënësi, ka patur parasysh se AKEP do ketë patur 1 vit kohë për të implementuar një mekanizëm monitorues të certifikuar për të vënë në aplikim këtë dispozitë.

Në këto rrethana, kur AKEP ende nuk ka implementuar një mekanizëm të tillë, do të ishte në kundërshtim me Ligjin nr. 54/2024 dhe i pamundur objektivisht, cdo detyrim i operatorit për të zbatuar këtë dispozitë në mungesë të një mekanizmi monitorues të certifikuar nga AKEP për të

vërtetuar me fakte sic kërkon qartazi dispozita, cdo mospërputhje të rëndësishme, të vazhdueshme ose të përsëritur rregullisht, midis cilësisë aktuale të shërbimit të aksesit në internet dhe performancës së treguar nga ofruesi i shërbimeve të aksesit në internet, në përputhje me shkronjat “a” deri në “d” të pikës 1 të nenit 178.

Gjithashtu, ONE Albania mendon se në kushtet e miratimit të Rregullave për Internet të Hapur dhe detyrimeve të operatorëve lidhur me garantimin e shpejtësisë së internetit, ofrimi i një mekanizmi të certifikuar nga AKEP për testimin e shpejtësisë së lidhjes IAS nga përdoruesi fundor do të shërbente për të patur një mekanizëm të konsoliduar, kërkesa të unifikuara për kriteret e zbatueshme në matjen e shpejtësisë, dhe për rrjedhojë konkurrencë më të drejtë e të ndershme në terma të cilësisë së shërbimit të ofruara nga ISP-të për shërbimet fikse. Në këto kushte, për të garantuar një aplikim të bazuar në Ligj, të drejtë, korrekt dhe të unifikuar, sugjerojmë që ndërkohë që operatorët të fillojnë përgatitjet për rishikimin e kushteve dhe termave të ofrimit të shërbimeve fikse dhe celulare lidhur me rregullat për internetin e hapur pas miratimit të Udhëzimeve përkatëse, zbatimi dhe hyrja në fuqi e tyre lidhur me nenin 178, pika 3, duhet të jetë i njëkohshëm me implementimin nga AKEP të mekanizmit të certifikuar.

Gjithashtu, është e paqartë se si do të implemetohet ky mekanizëm, nëse do të përdoret një platformë e jashtme apo nëse do kërkohej integrim me sistemet tona, etj. Pra janë një sërë elementësh lidhur me implementimin e mekanizmit monitorues nga AKEP të cilat kërkojnë qartësim për operatorët që edhe këta të fundit të marrin masat paraprake të nevojshme

(10) Duke qenë se testet e shpejtësisë së internetit janë mjete diagnostikuese që vlerësojnë performancën e lidhjes, dhe duke ju referuar faktit se në udhëzim rekomandohet përcaktimi i shpejtësisë minimale dhe normalisht të disponueshme në rrjetet fikse në % ndaj shpejtësisë së reklamuar/publikuar (Alternativa 2), mendojmë se shpejtësia e shkarkimit dhe shpejtësia e ngarkimit janë dy funksionalitete të domosdoshme, metrika dhe rezultatet për të cilat shërbejnë për garantimin e lidhjes së internetit të kontraktuar nga përdoruesi fundor me ISP-të ofrues të IAS.

Komentet e Albanian Fiber Telecommunications

(9-10) Afati i vendosur është me siguri në përputhje me shperndarjen e ngarkesës së AKEP-it dhe po ashtu në përputhje me kapacitetet njerezore që ka. Por parashikimin për në fund të vitit 2027 e konsiderojmë të largët si afat, dhe propozojmë për fillimvitin 2027. Kjo ndoshta mund të impaktojë ngarkesën dhe kapacitetet njerezore të AKEP-it, por situata është jo normale dhe kërkon zgjidhje edhe nepermjet parashikimit të kapaciteteve njerezore e financiare shtese.

Qëndrimi i AKEP për Komentete për Pyetjet 9-10:

AKEP ka marrë në konsideratë sugjerimet e palëve të interesuara për pyetjet 9-10, dhe në versionin final të Udhëzimeve (Shtojca 1: seksioni 2.1) ka shtuar një nënseksion në lidhje me informimin e pajtimtarëve për faktorë ndikues në rezultatet e matjes së shpejtësisë së aksesit në internet. Ky informacion bazohet në dokumentin e BEREC BoR (17) 178, dhe mund të përfshihet nga operatorët në kontratat e pajtimit për shërbim akses në internet në rrjete fikse dhe celulare, sipas faktorëve përkatëse ndikues.

Komente shtesë mbi Projekt-Udhëzimin

Komentet e One Albania:

(i) Përcaktimi në pikën 134 në projekt-udhëzim “Neni 178(3) zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ose të rinovuara nga data 20.12.2025”

Në dokumentin për konsultim publik, pika 134 përcakton se:

“Neni 178(1) dhe 178(2) zbatohen për të gjitha kontratat pavarësisht nga data e lidhjes ose rinovimit të kontratës. Neni 178(3) zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ose të rinovuara nga data 20.12.2025.”

Ne kuptojmë që cilësimi 20.12.2025 i referohet afatit 1 vjeçar nga data e miratimit të Ligjit nr.54/2024, përcaktuar në nenin 178, pika 3, por përveç sa parashtruam në përgjigje të pyetjes 9, duke konsideruar gjithashtu:

- i kohën e publikimit të këtij dokumenti për konsultim publik,
- ii periudhën 30-ditore të konsultimit,
- iii kohën e mundshme të miratimit të Udhëzimit përfundimtar,
- iv periudha 30 ditore për ankimin e mundshëm të Udhëzimit
- v procesin e draftimit të termave dhe kushteve të reja nga ISP-të për kontratën tip për shërbimet e rrjetit fiks dhe shërbimet e rrjetit celular,
- vi komunikimin në vijimësi në këtë proces deri në aprovimin nga AKEP të termave dhe kushteve të reja të përditësuara,
- vii përditësimet dhe përshtatjet e mundshme të produkteve të ofruara në treg në përputhje me kërkesat e Udhëzimit
- viii zhvillimet e mundshme të nevojshme në sistemet e brendshme të ISP-ve për të siguruar përshtatshmërinë e produkteve të përditësuara

qartazi afati i cituar në pikën 134 është i tejkaluar tashmë në kohë dhe nuk mund të qëndrojë, por sugjerojmë që si referuam edhe më lart në pyetjen 9, bazuar në përcaktimet e nenit 178, pika 3, të cilat eksplicitisht kërkojnë implementimin e një mekanizmi monitorues të certifikuar nga AKEP, si dhe duke marrë parasysh faktorët a-h më sipër, në mënyrë të arsyeshme përcaktimi në pikën 134 duhet të përditësohet si më poshtë:

“Neni 178(1) dhe 178(2) zbatohen për të gjitha kontratat pavarësisht nga data e lidhjes ose rinovimit të kontratës. Neni 178(3) zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ose të rinovuara nga data e implementimit të mekanizmit monitorues të certifikuar nga AKEP”.

(ii) Mbi reflektimin e rregullave për internetin e hapur në përmbledhjen e kontratës për paketat tarifore

Bazuar në vendimin e AKEP, nr.1, dt.02.02.2026 për miratimin e Rregullores për “Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, e cila hyn në fuqi nga data 01.05.2026, përcaktohet se përmbledhja e kontratës do të përfshijë në një nga seksionet e saj plotësimin e informacionit mbi: Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Në Aneksin 2 të rregullores jepen udhëzime mbi plotësimin e informacionit në përmbledhjen e kontratës ku për seksionin Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, kërkohet plotësim i përmbledhjes së informacionit të kërkuar sipas shkronjave “ç” dhe “d” të pikës 1 të Nenit 178 të Ligjit 54/2024.

Ndërkohë, ky projekt-udhëzim që do të shërbejë si guidë për sipërmarrësit për zbatimin pikërisht të përcaktimeve në nenet 177-179 të Ligjit 54/2024, dhe vecanërisht seksioni mbi Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, për një sërë rrethanash/faktorësh të përmendura më sipër, nuk mund të jetë i implementueshëm/zbatueshëm nga data 01.05.2026, qoftë për shkak të mungesës së një mekanizmi monitorues të certifikuar nga AKEP ashtu dhe për shkak të procesit të nevojshëm për rishikimin e termave dhe kushteve të reja të përditësuara të kontratës për tu zbatuar për abonentët e shërbimeve fikse dhe celulare, si dhe për plotësimin e informacionit në përmbledhjen e kontratës tip që gjithashtu do të jetë i njehsuar me informacionin në termat dhe kushtet.

Koment Vodafone Albania

Neni 177(6) Përpunimi i të dhënave personale

Në lidhje me këtë pikë, Vodafone paraqet dy aspekte të cilat kanë nevojë për qartësim nga ana e AKEP:

- i. Si dallon kufiri i monitorimit të trafikut sipas 177(6) nga masat e lejuara sipas 177(4) dhe 177(5)?
- ii. Nevojë për sqarim nëse AKEP do të ofrojë një udhëzim të vecantë për vlerësimin e nevojshmërisë dhe proporcionalitetit të masave të marra sipas nenit 177.

Qëndrimi i AKEP për Komentet shtesë

AKEP ka reflektuar pjesërisht sugjerimet e One Albania në versionin final të Udhëzimeve (Paragrafi 134 dhe Shtojca 1, Seksioni 2.3), duke bërë disa ndryshime dhe saktësime në lidhje instrumentat që mund të përdoren për matjet e shpejtësisë së IAS gjatë fazës tranzitore, deri në vendosjen në dispozicion të përdoruesve fundorë të mjetit të certifikuar nga AKEP (parashikuar gjatë vitit 2027). Gjithashtu AKEP në versionin final të Udhëzimeve (Paragrafi 187) ka përcaktuar datën 1.08.2026 si afat për ISP-të për zbatimin e dispozitave të Neneve 177-179 të Ligjit 54/2024 në lidhje me informacionin në kontratat e pajtimit/dokumentacionin kontraktor dhe publikimet përkatëse (për shpjeguesit e internetit dhe ceshtjet e tjera) sipas Udhëzimeve të AKEP, duke marrë në konsideratë kërkesën/komentin e One se afati 1.05.2026 (i propozuar në projekt-Udhëzim) ishte i pamjaftueshëm për operatorët.

Në lidhje me Komentet e Vodafone, AKEP sqaron se:

i. Dallimi ndërmjet nenit 177(6) dhe masave të lejuara sipas nenit 177(4) dhe 177(5) të Ligjit 54/2024?

Neni 177(4) dhe 177(5) i Ligjit 54/2024 përcaktojnë rastet dhe kushtet në të cilat lejohen masa të arsyeshme të menaxhimit të trafikut, Këto dispozita rregullojnë: “kur” dhe “në çfarë kushtesh” operatorët mund të ndërmarrin masa të menaxhimit të trafikut. Ndërkohë, Neni 177(6) lidhet me përpunimin e mundshëm të të dhënave personale gjatë zbatimit të këtyre masave dhe vendos kufizime/detyrime mbi mënyrën se si operatorët mund të analizojnë, monitorojnë ose përpunojnë trafikun dhe të dhënat e komunikimit.

AKEP thekson se fakti që një masë e menaxhimit të trafikut mund të jetë e lejuar sipas nenit 177(4) ose 177(5) të Ligjit 54/2024, nuk përjashton detyrimin për operatorin që çdo përpunim i mundshëm i të dhënave personale në këtë porces duhet të jetë i nevojshëm, proporcional; i kufizuar në minimumin e kërkuar, dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë në komunikimet elektronike (paragrafi 98 i Udhëzimeve).

Në këtë kuadër, AKEP sqaron se:

- masat e menaxhimit të trafikut nuk duhet të përdoren si bazë për monitorim të përgjithshëm të përmbajtjes ose sjelljes së përdoruesve;
- çdo analizë e trafikut duhet të kufizohet në atë që është teknikisht e domosdoshme për arritjen e qëllimit të lejuar nga ligji.

ii. Nevoja për udhëzime të veçanta mbi nevojshmërinë dhe proporcionalitetin

AKEP vlerëson se parimet e nevojshmërisë dhe proporcionalitetit të masave që mund të ndërmerren sipas nenit 177 të ligjit 54/2024 janë trajtuar në mënyrë të mjaftueshme në Udhëzimin e AKEP, i hartuar sipas Udhëzimeve më të fundit të BEREC BoR (22) 81.

Megjithatë, AKEP pranon se vlerësimi praktik i nevojshmërisë dhe/ose proporcionalitetit i masave të caktuar të menaxhimit të trafikut mund të kërkojë analizë rast pas rasti, duke marrë në konsideratë:

- natyrën e masës së menaxhimit të trafikut;
- ndikimin mbi përdoruesit fundorë;
- kohëzgjatjen dhe shtrirjen e masës;
- alternativat më pak ndërhyrëse;
- dhe ndikimin mbi privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë fazë, AKEP nuk vlerëson të nevojshme nxjerrjen e një udhëzimi të veçantë për nevojshmërinë apo proporcionalitetin e masave të menaxhimit të trafikut (përveç atyre që përmban Udhëzimi i AKEP), por do të monitorojë praktikën e tregut, si dhe do të marrë në konsideratë përditësimet e mundshme të udhëzimeve të BEREC për Internetin e Hapur në BE, dhe nëse rezulton e nevojshme, mund të publikojë sqarime ose udhëzime shtesë në të ardhmen, për këtë çështje, apo cdo çështje tjetër të lidhur me zbatimin e Neneve 177-179 të Ligjit 54/2024.